

Rigels Halili

Qendra për Evropën Lindore
Universiteti i Varshavës

“Ne, bijtë e kombit” – intelektualët si gjenerues të ideve dhe programeve kombëtare shqiptare dhe serbe

Abstrakt:

Ky artikull ofron një analizë krahasuese dhe tekstuale të dy dokumenteve shumë të rëndësishme: Memorandumit të Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve, të përgatitur në vitin 1986, si dhe të Platformës për Zgjidhjen e Çështjes Kombëtare Shqiptare, të paraqitur nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë në vitin 1998. Artikulli hulumton mbi rolin e intelektualëve si gjenerues të ideve, ideologjive dhe programeve kombëtare. Ai përfshin një analizë të detajuar të të dy dokumenteve e me tej në të analizohen kontekstet shoqërore e politike, në kuadër të të cilave u përgatitën këto dy dokumente. Njëkohësisht, artikulli përpiqet t'i vendosë këto dokumente në kontekstin e diskurseve nacionale serbe dhe shqiptare.

Fjalë kyçe:

Intelektualët, nacionalizmi, ide politike, programme politike

Në përkufizimin e tij gati proverbial të nacionalizmit¹⁸⁵ si ndjenjë dhe si lëvizje, Ernest Gellner (Ernest Gellner) tërheq vëmendjen drejt dy sferave, në të cilat zhvillohet çdo lëvizje kombëtare: sferën e ideve dhe sferën e aksionit politik (Gellner, 1991, 1). Ky artikull merret me të parën, por, kur e kërkon konteksti i analizës, i referohet edhe të dytës. Ai përqendrohet tek roli i intelektualëve dhe sidomos i studiuesve në procesin e formimit, ruajtjes dhe vënies në jetë të ideve dhe programeve politike ndër shqiptarë dhe serbë. Qëllimi im është të fokusohem tek dy dokumente kryesore, të cilat, siç do të përpiqem të tregoj, mund të shihen si përfaqësues simbolikë të një tradite të gjatë mendimi dhe idesh si në botën akademike serbe, ashtu edhe në atë shqiptare. Këto dy dokumente janë Memorandumi i Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve (ASShA), i cili u bë publik për herë të parë në vitin 1986, si dhe një dokument më pak i njohur – Platforma për Zgjidhjen e Çështjes Kombëtare Shqiptare, e paraqitur nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë (AShSh) në vitin 1998.

Shtrimi i nevojës për kërkim krahasues në Ballkan nuk është një kërkesë e re. Stavro Skëndi, një historian shqiptar, i cili pas Luftës së Dytë Botërore emigroi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shkroi një nga veprat më të rëndësishme mbi lëvizjen kombëtare shqiptare në shekullin XIX dhe fillim të shekullit XX, ngriti nevojën e një përjasjeje të tillë dhe e përdori atë me sukses në disa prej studimeve të veta (Skëndi, 1980, ix). Natyrisht, elemente krahasuese janë të pranishëm në perspektivën e përgjithshme analitike të përdorur nga disa prej historianëve më të mirë për Ballkanin, për të përmendur vetëm L. S. Stavrianos, Barabara Jelaviç (Jelavich), Zhorzh Kastelan (Georges Castellan), Trajan Stojanoviç (Traian Stoianovich), Stevan K. Pavloviç (Stevan K. Pavlowitch) dhe Mark Mazauer (Mark Mazower). Duke marrë kërkesën e Skëndit si pikënisje, do të mbështetem këtu tek një model paksa më i qartë, të cilin e ka përdorur Miroslav Hroh (Miroslav Hroh), një nga historianët dhe sociologët kryesorë çekë, në veprën e tij kushtuar premisave shoqërore të zhvillimit të lëvizjeve kombëtare ndër kombet e vegjël në Evropë. Sipas Hrohut duhet të merren në konsideratë katër kushte: a) objekti i krahasimit duhet të përkufizohet sa më qartë që të jetë e mundur; b) duhet të paraqitet qëllimi i ndërmarrjes së krahasimit; c) duhet të përcaktohen kriteret mbi të cilat do të mbështetet analiza krahasuese; d) duhet të sqarohet lidhja midis procedurës krahasuese dhe aksit kohor (dmth. kronologjisë historike në sensin absolut)” (Hroch, 1985, 18).

Nuk është aspak qëllimi im, që me anë të kësaj analize të provoj “fajin” apo të mbështes “të vërtetën” e autorëve të këtyre dy dokumenteve. Në fakt, pikërisht këto dy koncepte – *e vërteta* dhe *faji* – shërbyen si dy shtylla kryesore emocionale dhe ideologjike, të cilat, përkrah prestigjit institucional dhe mbështetjes politike, i dhanë legjitimitet këtyre dy dokumenteve. Gur themeli i strukturës së tyre është e njëjta

¹⁸⁵ Në gjuhën angleze nuk ekziston një ndryshim kaq i artikuluar, sa në gjuhët evropiano-qendrore dhe ballkanike, e ndër to edhe në gjuhën shqipe, midis nocioneve *lëvizje kombëtare* dhe *nacionalizëm*, ku e para shihet si diçka pozitive, ndërkohë që i dyti si një fenomen negativ. Për Gellnerin, ashtu si edhe për shumë klasikë të studimeve mbi nacionalizmin, këto dy nocione janë të pandashme. Për këtë arsye, në këtë tekst do të përpiqem t’i ruaj nuancat kuptimore të të dy nocioneve e sipas rastit, të sqaroj se për se bëhet fjalë.

logjikë e ekzistencës së një ndarjeje të prerë dhe të pakthyeshme midis *nesh* dhe *atyre*. Receta është e thjeshtë dhe e njohur edhe nga raste të tjera: *ne* jemi viktimat, ndërsa aspiratat tona janë paqësore, të vërteta dhe të drejta, ndërkohë që *ata* kërkojnë me të padrejtë, janë agresorë dhe, si rregull, kryejnë krime, të cilat vënë në rrezik vetë qenien *tonë* si grup. Por kuptimi i kësaj logjike është vetëm hapi i parë. Një veprim më interesant, e ndoshta edhe më i dobishëm nga ana kulturore dhe shoqërore, do të ishte evidentimi dhe vlerësimi kritik i vazhdimësisë së ideve të shprehura në këto dy dokumente, i rolit të intelektualëve në këtë proces, si dhe, së fundi, i ndikimit të institucioneve shkencore ose kulturore të ndërtuara apo të mbështetura nga shteti. Kjo gjë do të kërkonte kryerjen e analizës në të paktën dy nivele: gjuhësor dhe socio-historik.

Në një artikull të shkurtër të shkruar në vitin 1993, Shkëlzen Maliqi, një nga figurat kryesore midis publicistëve shqiptarë nga Kosova, shkruante se sfera verbale e komunikimit midis dy diskurseve ekstreme nacionaliste serbe dhe shqiptare kishte arritur tashmë në atë pikë, pas së cilës mbetet vetëm lufta (Maliqi, 1994, 77). U deshën vetëm disa vite që lufta të mbërrinte dhe pasojat e saj vazhdojnë të ndihen dhe do të ndihen për një kohë të gjatë në Kosovë, Serbi dhe Shqipëri. Lindin disa pyetje bazë: si ndodhi e gjithë kjo, kush e mban përgjegjësinë për ngjarjet e atëherëshme dhe si të veprojmë sot me pasojat e tyre? Do të përpiqem të gjej përgjigje për këto pyetje duke parë nga afër të dyja palët, apo e thënë ndryshe – në tërësinë e dialogut midis tyre, edhe kur forma kryesore e tij ishte heshtja apo përjashtimi total i tjetrit. Pa dyshim, përqasja krahasuese e propozuar këtu mund të sjellë dobi vetëm nëse analiza merr parasysh natyrën dialogore (duke përdorur në një kontekst tjetër konceptin e Bahtinit) të çdo konflikti etnik, përfshirë këtu edhe të atij shqiptaro-serb. E, siç do të argumentonte Bahtini, është ky një dialog i cili përzgjatet në të dyja anët, duke përfshirë dhe duke ndikuar thellë dhe njëkohësisht tek të dyja palët (Bahtin 1982).

Si Memorandumi i ASShA-së, ashtu edhe Platforma e AShSh-së janë prodhim i rrethanave të caktuara historike, të cilat duhet të merren parasysh gjatë kryerjes së një analize të tillë krahasuese. Privilegji që jep vështrimi mbi çështjet pasi ka kaluar tashmë një kohë e gjatë prej tyre, mund të mjeçullojë qartësinë e analizës, prandaj është e këshillueshme të bëhet kujdes në nxjerrjen e përfundimeve. Siç theksohet nga shumë studiues, Memorandumi i parapriu ndryshimeve rrënjësore të pozitës kushtetuese të Vojvodinës dhe Kosovës në 1989, apo ndoshta edhe ndikoi ndjeshëm në ndërmarrjen e tyre. Nuk është rastësi që Platforma e paraqitur nga AShSh-ja në 1998, kur ndeshjet midis Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave policore e ushtarake jugosllave, si dhe njërive paraushtarake, morën trajtën e luftës së hapur, e cila disa muaj më vonë u kthye në katastrofë humanitare dhe çoi në bombardimin e Republikës Federale të Jugosllavisë nga NATO. Por, po aq e rëndësishme është që këto dokumente të shihen në një kontekst më të gjerë historik, sepse ato janë shprehje e një tradite idesh dhe mënyra mendimi, të cilat zënë fill bashkë me fillimet e lëvizjeve moderne kombëtare serbe dhe shqiptare. Mënyra më e mirë për ta treguar këtë është leximi i vëmendshëm dhe kritik i të dy dokumenteve.

Çfarë ka aty?

Për ata që studjojnë apo u ligjërojnë studentëve të vet mbi shpërbërjen e Jugosllavisë komuniste, Memorandumi i ASShA-së shfaqet shpesh si një nga ato shprehjet e goditura, që shpjegojnë gjithçka, një metaforë që përmbledh vetë esencën e nacionalizmit serb, zanafillën e rrugëtimit që çoi tek lufta, shkatërrimi i vendit dhe tragjedi humane të panumërta. Në fakt, shumë shpesh Memorandumi as që citohet, faktet ngatërrohen, ndërsa përmbajtja e tij thjeshtohet me gabime. Nga ana tjetër, Platforma e ASHSh-së nuk është edhe aq e njohur dhe, mesa di unë, akoma nuk është bërë objekt i ndonjë analize të thellë shkencore. Për këtë arsye duket me vend ta nisim nga një vështrim i thelluar i përmbajtjes së të dy dokumenteve.

1. Memorandumi i ASShA-së

Struktura e Memorandumit mund të përmbliidhet në titujt e dy pjesëve, nga të cilat përbëhet. Në pjesën e parë të titulluar *Kriza e ekonomisë dhe shoqërisë jugosllave* autorët analizojnë kontekstin jugosllav, ndërsa në pjesën e dytë të titulluar *Statusi i Serbisë dhe i kombit serb*, ata përqendrohen tek çështjet serbe. Është interesante të vihet re se teksti nis nga çështjet ekonomike dhe jo nga ato politike. Autorët nuk lënë aspak për të dyshuar: kriza e thellë ekonomike dhe shoqërore në Jugosllavi mund të sjellë “pasoja kaq katastrofike” sa vetë shpërbërja e saj (Mihailović, Krestić, 1995, 95). Për ta, ritmet e ulëta të rritjes ekonomike dhe niveli i lartë i papunësisë gjatë gjysmës së parë të viteve 80-të, e kishin zanafillën tek gabimet e bëra gjatë viteve 60-të, kur mungesa e planifikimit qendror dhe decentralizimi u bënë parimet kryesore mbi të cilat mbështetej ekonomia. Kjo solli fragmentimin e ekonomisë jugosllave në ekonomi republikane gati të ndara nga njëra-tjetra, çka për pasojë solli krizën (Ibid., 97). Sipas mendimit të autorëve, reagimi i dobët i qeverisë federale ishte në fakt rezultat i një qëllimi të fshehur për t’u dhënë më tepër pushtet udhëheqësve republikanë (Ibid., 101-102). Ky përfundim i hap derën një kritike të plotë nga ana e autorëve të tendencave federative, të cilat arritën kulmin me kushtetutën e vitit 1974. Ky dokument shkaktoi një situatë ku “interesat etnike u vendosën mbi ato klasore dhe provincat u përqendruan më shumë tek statusi i tyre si një element përbërës i federatës, sesa tek fakti se janë pjesë përbërëse e Serbisë (Ibid., 104-105). Tingëllon disi ironik fakti që autorët e Memorandumit vënë theksin tek kriteri klasor, një nga kategoritë bazë të marksizmit, duke kritikuar njëkohësisht politikën e autoriteteve qendrore, të cilat legjitimitetin e pushtetit të vet e mbështesnin pikërisht tek ideologjia marksiste. Ky qëndrim kritik mprehtësohet edhe më tej, kur autorët e cilësojnë ndikimin e Kominternit mbi Partinë Komuniste të Jugosllavisë para Luftës së Dytë Botërore si një nga shkaqet kryesore të këtij dominimi të parimeve etnike mbi ato shtetërore. Edhe pse në mënyrë indirekte, ata fajësojnë Edvard Kardelin (Kardelj), idetë e të cilit mbi lëvizjen kombëtare sllovene

shërbyen si bazë për ndërtimin e modelit jugosllav (Ibid., 107). Ata përfundojnë me një konkluzion të themtë: “I paorganizuar tashmë deri në kufijtë e të paarsyeshmes, shteti ka degjenuar në një formë vullnetarizmi republikan, provincial dhe komunal” (Ibid., 110).

Por autorët i shqetëson edhe më tepër “kriza morale”. Ajo është e thellë dhe ka përfshirë tashmë bazat e shoqërisë jugosllave, theksojnë ata. Në vetvete, ajo përbën një devijim nga idetë socialiste, apo ndoshta edhe dështim të tyre, i cili manifestohet në mentalitetin e mbyllur fshatar, nepotizmin, korrupsionin, vjedhjet, falsifikimin dhe kriminalitetin, të pranishme tashmë kudo, në çdo segment të jetës shoqërore. Ndikimi shkatërrues i papunësisë, humbja e besimit tek barazia shoqërore dhe migracioni intensiv janë elemente të tjera shtesë të këtij mozaiku kalbjeje të paraqitur nga autorët. Siç ndodh rëndom, theksojnë ata, kriza e vlerave shkon krah për krah me krizën kulturore. Primitivizmi, provincializmi dhe kiçi janë të pranishëm gjithkund në letërsi, muzikë, arte, shtyp dhe televizion. Konkluzioni i tyre përsëri tingëllon hidhët, por në fakt është e vështirë të mos jesh dakort me të: “Ideologjia zyrtare, e cila në vend të një programi të vërtetë socialist, ofron vetëm proklamata boshe politike, e ka humbur tashmë plotësisht aftësinë për të fituar zemrat e njerëzve. (...) Thellësisht të rrënjosura në jetën provinciale, separatizmi dhe nacionalizmi po bëhen gjithmonë e më agresivë” (Ibid., 114). Mungesa e transparencës dhe demokracisë në jetën shoqërore, dështimi i sistemit të vetë-administrimit, i ashtuquajturit etatizëm, dhunimi i të drejtave elementare të individit, si liria e fjalës dhe liria e të organizuarit, të gjitha këto në total, sipas autorëve, e lënë Jugosllavinë shumë mbrapa në krahasim me vendet e tjera të qytetëruara. Zgjidhja, shkruajnë ata, duhet të vijë nga lart: “Për aq kohë sa do të mbetet në fuqi Kushtetuta¹⁸⁶ dhe sistemi politik dhe ekonomik i mbështetur mbi të, zgjidhja e çfarëdolloj problemi të shoqërisë sonë do të jetë e pamundur; procesi i dezintegritimit do të thellohet dhe vendi do të rrëshqasë drejt një krize edhe më të thellë” (Ibid., 117).

Kjo diagnozë e hidhur dhe e errët për Jugosllavinë bëhet parantezë për pjesën e dytë të dokumentit, ku autorët diskutojnë pozicionin e Serbisë dhe të serbëve në përgjithësi. Menjëherë lexuesi ndjen një ndryshim në retorikë, e cila nga një formë zyrtare dhe disi mekanike merr një trajtë më pasionante e bile herë-herë kalon në tone personale. Diskutimin e hap një mendim i qartë: “Shumë nga shqetësimet që prekin kombin serb vijnë nga rrethana, të cilat janë të njëjta për të gjithë kombet e tjera jugosllave. Por, populli serb përballet edhe probleme të tjera. Prapambetja për një kohë të gjatë e ekonomisë serbe, mosrregullimi i lidhjeve ligjore midis Serbisë dhe Jugosllavisë e dy provincave, si dhe gjenocidi në Kosovë, të gjitha këto probleme janë shfaqur tashmë në skenën politike dhe me forcën e tyre të kombinuar po e tensionojnë edhe më tej situatën, në mos po e çojnë atë drejt shpërthimit.” (Ibid., 119). Kjo hapje i jep tonin kësaj pjese të Memorandumit, pra se Serbia është shfrytëzuar nga Jugosllavia gjatë gjithë periudhës së pasluftës. Përsëri në qendër të vëmendjes

¹⁸⁶ Autorët e Memorandumit e shkruajnë këtë emër me shkronjë kapitale, prandaj vendosëm që ta ruajmë në citim këtë formë (shën i aut. dhe red.).

është ekonomia dhe ajo formon bazën e argumentimit të autorëve. Ata shprehen se megjithë efikasitetin e investimeve gati të njëjtë në Serbi, ashtu si edhe në Slloveni dhe në Vojvodinë, e ndoshta më të lartin në Jugosllavi, shpenzimet per capita janë nga më të ulëtat. Për më tepër, rregulla të pafavorshme tregtie e kanë dobësuar edhe më tej ekonominë serbe. Arsyet e kësaj gjendjeje nuk janë ekonomike, pohojnë autorët, por ideologjike dhe janë të rrënjosura thellë në strategjinë e Kominternit, i cili para luftës e shihte borgjezinë serbe si “shtypëse” të kombeve të tjera jugosllave. Pas luftës Partia Komuniste e Jugosllavisë e pranoi këtë strategji dhe e ktheu në një politikë të vetëdijshe të pozicionimit të Serbisë dhe ekonomisë serbe brenda federatës. Ishte dyshja Tito-Kardel, pohojnë autorët, e cila në Jugosllavinë e re me vetëdije e kufizoi Serbinë, duke i dhënë përparësi Sllovenisë dhe Kroacisë, bile edhe Vojvodinës, sidomos kur bëhet fjalë për industrializimin dhe përdorimin e fondeve nga Fondi Federal i Zhvillimit (Ibid., 122-123).

Kritika e autorëve përqendrohet sidomos tek kushtetuta e vitit 1974. Për ata ky dokument thjesht diskriminon Serbinë, sepse e ndan Vojvodinën dhe Kosovën nga Serbia. Thënia e vjetër “një Serbi e dobët siguron një Jugosllavi të fortë” u mbrujt këtu në parimin e barazisë së përfaqësuesve të republikave të ndryshme, i cili, siç shprehen autorët, solli kufizimin e mundësive të serbëve për t’u punësuar në poste federale. Për më tepër, mekanizmi i komplikuar i ndarjes së kompetencave midis Serbisë dhe provincave autonome federale shkaktonte konfuzion të përgjithshëm në procesin e vendimmarrjes, politikën e brendshme dhe zhvillimin ekonomik, si dhe humbje të sovranitetit të kombit serb. Vetëm kombi serb, theksojnë autorët, nuk është i përqendruar në një republikë. Kështu, kjo çështje shkon shumë më tej se diskutimet kushtetuese, sepse ka të bëjë me vetë ekzistencën e kombit serb dhe shtetit të tij. Autorët nuk lënë asnjë dyshim mbi motivet që i shtynë të trajtojnë situatën në Kosovë: “Gjenocidi fizik, politik, juridik dhe kulturor i popullsisë serbe në Kosovë dhe Metohi është humbja më e madhe nga të gjitha ato që ka pësuar Serbia në luftërat e saj për çlirim që nga Kryengritja e Parë Serbe në vitin 1804 deri në kryengritjen e vitit 1914” (Ibid., 128). Nga kjo pikë e më tutje toni i Memorandumit bëhet i mprehtë dhe i drejtpërdrejtë, duke tingëlluar aty këtu me nota katastrofike, ndërsa vendin e argumenteve ekonomike e zënë ato historike. Vazhdimësinë e politikës së Kominternit, injorancën dhe oportunitizmin e politikanëve serbë, si dhe neglizhencën totale të elitave politike kosovare autorët i shohin si shkaqet kryesore të përkeqësimit të thellë të gjendjes së popullsisë serbe në Kosovë. Kjo është një luftë e hapur dhe totale, pohojnë autorët, që shqiptarët po e bëjnë në mënyrë të vetëdijshe dhe të gjithanshme. Është një luftë e mbështetur nga qeveria e Tiranës, duke ndjekur një plan kombëtar shqiptar të detajuar dhe vazhdimisht të aktualizuar. Në Kosovë, shtojnë ata, serbët po bien pre e krimeve, dhunës dhe terrorit, ndërsa raste si ai i Gjorgje Martinoviqit (Đorđe Martinović)¹⁸⁷ të kujtojnë “ditët më të errëta

¹⁸⁷ Këtu autorët i referohen të ashtuquajturit “skandali Martinoviq”, i cili shpërtheu në maj të vitit 1985 dhe më vonë u bë i bujshëm në shtypin serb dhe atë jugosllav. Gjatë një hetimi të kryer pas ngjarjes nga një kolonel i Ushtrisë Popullore Jugosllave (pse e kreu këtë hetim ushtria dhe jo policia, ngrihet pyetja), asokohe 56-vjeçari Gjorgje Martinoviq, pranoi se kishte pësuar një aksident gjatë kryerjes së një akti anal masturbimi. Kjo gjë u konfirmua edhe nga mjekë lokalë në Kosovë. Por, pas transferimit të

të praktikës turke të nguljes në hu” (Ibid., 129). Por më i rëndësishëm është fakt, se serbët po dëbohen nga provinca dhe kjo përbën fazën finale të një procesi i cili ka filluar shumë më herët. Në mbështetje të këtij pohimi, autorët japin të dhëna të sakta demografike. Duke cituar Jovan Cvijiqin, ata shprehen se gjysëm milioni serbë e kanë lënë Kosovën qysh nga viti 1690 deri në fillim të shekullit XX. Prej tyre, gati 150000 ikën nga Kosova në periudhën 1876-1912 të terrorizuar prej bashibozukëve shqiptarë. Një grup tjetër prej 60000 personash e braktisi Kosovën gjatë Luftës së Dytë Botërore, ndërsa numrin e atyre që u detyruan të ikin nga provinca në vitet 70-të dhe 80-të, autorët e vlerësojnë në 200000 vetë (Ibid., 129). Zhvillime të tilla lënë shumë pak shpresë për të ardhmen, shprehen autorët. Kosova, djepi i Serbisë, mund të zbrazet shumë shpejt nga serbët dhe kështu programi, siç i quajnë ata, i “shqiptaromëdhenjve racistë”, i skicuar qysh në Lidhjen e Prizrenit, do të realizohet plotësisht. Megjithatë, edhe pse mungon mbështetja nga autoritetet e provincës, po merr jetë opozita nga poshtë, nga populli, i cili duhet të kërkojë ndihmën e qeverisë republikane. Duhet bërë çdo gjë për të mundësuar kthimin e serbëve të dëbuar në shtëpitë e tyre, kërkojnë autorët, përndryshe “kjo pjesë e Republikës së Serbisë dhe Jugosllavisë do të kthehet në një çështje evropiane me pasoja nga më të rëndat e të paparashikueshme” (Ibid., 130). Kërkesa për një Kosovë të pastër etnike, konkludojnë ata, do të hapë dyert e ekspansionizmit, i cili do të rrezikojë të gjitha grupet etnike që jetojnë në Jugosllavi.

Pasi paraqesin një pamje të ngjashme katastrofike në lidhje me situatën e serbëve tjetërkund në Jugosllavi, sidomos në Kroaci dhe në Vojvodinë dhe pasi kërkojnë reforma të thella të sistemit të edukimit, sepse “prova të keqtrajtimit të serbëve dhe të kulturës serbe mund të gjenden në programet shkollore në të gjitha republikat jugosllave”, autorët vijnë tek konkluzionet e tyre. Ata rishprehin dhe ritheksojnë kërkesat që dominojnë në të gjithë tekstin. Së pari, heqja dorë nga ideologjia e mbështetur nga Kominterni dhe e mbrujtur në politikën e Partisë Komuniste të Jugosllavisë, si dhe – siç mund të nënkuptohej – të pasueses së saj, Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë. Së dyti, heqja nga kombi serb e stigmatizimit se ai është shtypësi i kombeve të tjera të Jugosllavisë. Dhe së treti, “formimi i integritetit të plotë kombëtar dhe kulturor të popullit serb, pa marrë parasysh se në cilën republikë apo provincë banon, është e drejta e tij historike dhe demokratike” (Ibid., 138). Prej këtej, ata kërkojnë që provincat autonome të bëhen përsëri pjesë integrale e Republikës së Serbisë, që “gjenocidi në Kosovë” të ndalet me çdo kusht dhe të merren të masat për t’ua mundësuar Serbëve kthimin në “shtëpitë e tyre të hershme”. Ata përfundojnë, duke bërë thirrje për një mobilizim të përgjithshëm demokratik “të të gjitha forcave morale dhe intelektuale të kombit, jo vetëm për të plotësuar vendimet e marra nga udhëheqësit politikë, por për të ravigjësuar programe dhe ndërtuar të ardhmen në mënyrë demokratike” (Ibid.,

Martinoviqit në Beograd, një grup tjetër mjekësh nga Akademia Ushtarake Mjekësore i dha të drejtë një rrëfimi pak më të vonshëm të tij, ku ai u shpreh se ishte sulmuar nga dy shqiptarë të maskuar, të cilët i kishin futur me forcë një shishe në anus. Një opinion i dytë i përgatitur nga një komision i drejtuar nga profesori Janez Milčinski (Milčinski) konkludoi se plagët mund të ishin efekt i një akti masturbimi, por nuk e përjashtoi edhe mundësinë e një akti dhune. Rasti nuk u bë kurrë objekt i një hetimi zyrtar dhe vazhdon të mbetet i hapur për diskutim apo spekulime (Soso, 2002, 132-135).

139-140). Pasi lexon të gjithë dokumentin, lexuesi mbetet me përshtypjen se vështirë se mund të gjendet një provë më e dukshme e mobilizimit të forcave intelektuale të kombit dhe ndërtimit të programeve sesa vetë teksti i Memorandumit.

2. Platforma e AShSh-së

Megjithëse e shkruar dhe e bërë publike në rrethana krejt të tjera, toni dhe retorika e Platformës janë të ngjashme me ato të Memorandumit. Parathënia lë shumë pak dyshim për motivet dhe qëllimet e autorëve të saj: ky është një dokument i cili paraqet me vërtetësi të kaluarën, analizon të tashmen dhe parashtron zgjidhje për të ardhmen. Kjo mënyrë e ndërtimit të tekstit të sjell ndërmend manifestin më të rëndësishëm të lëvizjes kombëtare shqiptare, librin *Shqipëria, ç'ka qënë, ç'është e ç'do të bëhetë?* të shkruar nga Sami Frashëri dhe të botuar anonimisht në 1899. Megjithëse librin e Samiut e ndan një shekull nga Platforma, duket qartë se autorët e saj janë nën ndikimin e po të njëjtave ide si edhe mendimtari i shquar dhe të shtyrë nga po e njëjta domosdoshmëri urgjente për të ndihmuar kombin në nevojë. Por ekziston një ndryshim në vënien e theksit. Për Samiun, Shqipëria qe një realitet gjeografik, i cili përfshinte pak a shumë të gjitha territoret e banuara plotësisht apo pjesërisht nga shqiptarët, por një njësi politike akoma në procesin e formimit. Ndërkohë, për autorët e Platformës, Shqipëria është tashmë një entitet politik, por i dëmtuar rëndë nga fakti se gjysma e kombit jeton jashtë shtetit kombëtar. Samiu e përfytyronte këtë shtet dhe dha ide mbi organizmin e tij, autorët e Platformës japin zgjidhje për rregullimin e tij. Qëllimi kryesor nuk është të provohet ekzistenca e kombit shqiptar, siç ndodhte me Samiun, por të jepen argumente historike dhe të tjera në mbështetje të të drejtave të kombit për vetëvendosje dhe sovranitet. Samiu mund të quhet një nga baballarët e kombit, autorët e Platformës e paraqesin veten si bijtë e tij të shqetësuar.

Koha e shkrimit ishte vendimtare. Ishte viti 1998 dhe situata në Kosovë e fati i shqiptarëve që banonin aty janë në qendër të vëmendjes së autorëve. Megjithatë, ashtu siç ishte me rastin e Memorandumit, Kosova duket vetëm një pretekst për të diskutuar situatën e të gjithë kombit. Por në ndryshim nga kolegët e tyre serbë, autorët shqiptarë e nisin nga historia. Ata e lokalizojnë origjinën e lëvizjes kombëtare shqiptare gjatë “okupimit osman”, gati paralelisht me krijimin e programeve kombëtare të grekëve dhe serbëve, respektivisht *Megali Idea* dhe *Načertanie*. Është e rëndësishme të vihet re theksimi i kronologjisë së lindjes së programeve kombëtare sepse kjo kundërshton idenë e shprehur rëndom se lëvizja kombëtare shqiptare¹⁸⁸ ishte e vonuar në Ballkan. Në mbështetje të tezës së tyre, autorët e Platformës citojnë disa udhëtarë evropianë të asaj periudhe, që për nga vetë pozicioni i tyre mund të quhen vëzhgues objektivë, të cilët në shkrimet e tyre përkufizojnë përmasat e trojeve të banuara nga shqiptarët,

¹⁸⁸ Në historiografinë shqiptare ky term shënohet me shkronja kapitale. Propozoj këtu formën shkronja kapitale, duke u nisur nga premisa e mosesencializmit të lëvizjes sonë kombëtare. E thënë ndryshe, nga pikëpamja e thelbit ideor, qëllimeve politike dhe aspekteve shoqërore e kulturore lëvizja kombëtare shqiptarëve nuk ndryshon dhe aq nga lëvizjet kombëtare të kombeve të tjera në Evropën Qendrore dhe në Ballkan.

duke i quajtur këta të fundit “pasardhës të ilirëve të lashtë” që në këto toka “kanë jetuar që nga agimet e historisë” (Platform, 1998, 6). Mbi këto baza, autorët e Platformës paraqesin prerazi kufijtë e asaj që mund të quhet hapësira gjeografike e banuar nga shqiptarët. Kufiri shkon në jug të Nishit drejt Leskovacit dhe Vranjës, e pastaj nëpër Kumanovë, Prilep, Bitola dhe kthehet në perëndim drejt Janinës për të përfunduar në Prevezë. Është e rëndësishme të vihet re se autorët përdorin vetëm format shqipe të këtyre emrave, psh. Shkup dhe jo Skopje, Manastir dhe jo Bitola, Janinë dhe jo Ioannina. Kjo tendencë manifestohet gjithkund në tekst, sidomos me përdorimin e emrit Kosova dhe jo Kosovo¹⁸⁹ në përkthimin e tij në anglisht, çka nuk përbën vetëm një zgjedhje semantike, por mbi të gjitha politike. Le të shtojmë në marginë se kjo zgjedhje korrespondon shumë mirë me përdorimin e termin *Kosovo i Metohija* në përkthimin anglisht të tekstit të Memorandumit të ASShA-së.

Autorët e Platformës e pranojnë faktin se në këto territore nuk jetonin vetëm shqiptarët, por ata theksojnë se popullatat jo-shqiptare ishin “ishuj pakicash në detin e hapur shqiptar” (Ibid., 6). Një vërejtje e tillë vetëm sa përforcon interpretimin dominues në historiografinë zyrtare në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore për sa i përket mozaikut etnik të kësaj zone të Ballkanit perëndimor. Në këtë kontekst, autorët e Platformës i referohen idesë themelore të programit politik të lëvizjes kombëtare shqiptare në fund të shekullit XIX, asaj të bashkimit të katër vilajeteve osmane të banuara nga shumica shqiptare –(në origjinal) Kosova, Işkodra, Manastir dhe Yania – në një vilajet shqiptar.¹⁹⁰ Por ata shkojnë më tej në interpretimet e tyre, duke e lidhur territorin e vilajetit të Kosovës me Dardaninë ilire, ndërsa atë të vilajetit të Janinës me provincën e Epirit. Kështu, ata përvijojnë një linjë të pandërprerë të vazhdimësisë iliro-shqiptare në këto territore, e cila i bën krejt të paarsyeshme pretendimet territoriale serbe dhe greke mbi to (Ibid., 7).

Që nga kjo pikë e më tej, Platforma rikapitullon tendencat kryesore në historiografinë shqiptare për sa i përket vlerësimit të kapërcyellit të shekujve XIX dhe XX dhe paraqet një polemikë me kërkesat historike dhe/ose interpretimet dominuese në historiografitë serbe dhe greke. Disa nga autorët e paidentifikuar me emra të Platformës ishin po ata historianë që me forma dhe nëpërmjet kanaleve të tjera i zhvillonin këto polemika qysh më herët. Po, r më i rëndësishëm është fakti se edhe kundërshtarët “serbë” dhe “grekë” janë pa emra, të grupuar në një kategori, të homogjenizuar si “të tjerët”, që mohojnë të drejtat tona. Nga kjo pikëpamje, Platforma tregon gjithashtu një ngjashmëri të dukshme me logjikën që përshkon tejet Memorandumin e ASShA-së.

¹⁸⁹ Shqiptarët e quajnë pjesën perëndimore të Kosovës *Rrafshi i Dukagjinit* dhe kjo zonë korrespondon pak a shumë me atë, që serbët e quajnë *Metohi*. Për mendimin tim, në të dyja gjuhët terme dominuese janë *Kosova* dhe *Kosovo*, ndërsa përdorimi i emrave më të zgjatur – më rrallë *Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit*, e sidomos *Kosovo i Metohija* – paraqesin zgjedhje politike.

¹⁹⁰ Kjo ide u shfaq për herë të parë në shkrimet e anëtarëve të Komitetit Qendror për Mbrotjtjen e të Drejtave të Kombësive Shqiptare në 1877 në Stamboll. Më vonë ajo hyri në programin e ndryshuar të Lidhjes së Prizrenit, duke u kthyer kështu në kërkesë qendrore të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Më në fund ky vilajet u krijua në 4 shtator 1912, vetëm për t'u shkatërruar një muaj më vonë me fillimin e Luftës së Parë Ballkanike (Pollo, Buda, 1963, 125).

Autorët mohojnë pretendimet se ortodoksët shqiptarë qenë grekë, çka i çon ata tek hedhja poshtë e aspiratave greke kundrejt Epirit dhe Shqipërisë jugore. Për ta, ekspansioni serb në Kosovë dhe në Shqipërinë veriore ishte rezultat i kërkesës imperialiste për dalje në detin Adriatik. Ata e gjejnë zanafillën e kësaj politike të pranishme qysh tek *Načertanie*, por asnjë fragment nga ky dokument nuk citohet. Më tej, autorët e Platformës emërtojnë si gënjeshtër pretendimet e “qarqeve nacionaliste beogradase”, të cilat duke mohuar orgjinën ilire të shqiptarëve në të vërtetë mohojnë prezencën dhe autoktoninë shqiptare në Kosovë.

Për autorët e Platformës, Migrimi i Madh serb i 1689/1690 përbën thjesht një trillim historik, ndërsa pretendimet serbe se shqiptarët muslimanë në provincë bashkëpunuan me autoritetet osmane, apo se me vetëdije shkatërruan manastiret ortodokse, ata i quajnë absurde. E vërteta është krejt ndryshe, theksojnë autorët, familjet shqiptare u kujdesën dhe i ruajtën manastiret serbe. E kjo ndodhi përkundrejt praktikës së sundimtarëve mesjetarë serbë, të cilët pasi “okupuan Kosovën”, shkatërruan çdo monument kulturor dhe fetar të hershëm të shqiptarëve (Ibid., 7-8).

Kosova ka qenë gjithmonë një qendër e rezistencës shqiptare kundër turqve, theksojnë autorët. Ata përmendin peshkopin Pjetër Bogdani si organizator të kryengritjes së vitit 1689, por ata shtojnë menjëherë se jo vetëm katolikët, por edhe muslimanët luftuan kundër turqve, siç ndodhi me kryengritjen e vitit 1844, të drejtuar nga Dervish Cara. Lidhja e Prizrenit i dha një drejtim të ri Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, vazhdojnë më tej autorët, megjithëse u shtyp me forcë nga ushtritë osmane, saqë toka kosovare u përsquq nga gjaku i mijëra bijve të saj (Ibid., 9). Kosova u bë përsëri qendër e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare gjatë kryengritjes së përgjithshme të vitit 1912, e cila përgatiti terrenin për shpërthimin e Luftës së Parë Ballkanike. Autorët e Platformës theksojnë se ndër delegatët e mbledhur në Vlorë, të cilët shpallën pavarësinë e Shqipërisë më 28 nëntor 1912, kishte përfaqësues nga të gjitha trojet e banuara nga shqiptarë, “duke përfshirë edhe Kosovën dhe Çamërinë”. Por, të dobësuar nga kryengritjet e vazhdueshme dhe luftërat, shqiptarët nuk ishin në gjendje ta ndalonin përparimin e forcave serbe dhe greke respektivisht, drejt Kosovës dhe Çamërisë e Shqipërisë jugore. Për autorët e Platformës nuk ka dyshim se vendimet e Konferencës së Ambasadorëve të Fuqive të Mëdha, të mbledhur në Londër në 1913, përbëjnë për shqiptarët një traumë të vërtetë, sepse Kosova, pjesë të Maqedonisë dhe Çamëria u lanë jashtë Shqipërisë së sapo lindur. Kjo, theksojnë autorët, ishte një padrejtësi e madhe, e cila iu bë “një kombi të vjetër, që i kishte mbijetuar stuhive të vazhdueshme të historisë”. Këto vendime sollën shpërnguljen e detyruar të shqiptarëve nga Kosova dhe Maqedonia për në Turqi, ndërkohë që fundi i kësaj linje të gjatë të dhimbjeve dhe represionit ishte “eksodi biblik i Çamëve”, në përfundim të Luftës së Dytë Botërore (Ibid., 11).

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, vazhdojnë më tej autorët, Shqipëria ishte vetë e pushtuar, fillimisht nga fashistët italianë e pastaj edhe nga nazistët gjermanë, prandaj nuk mund të ndodhte një bashkim i vërtetë i Kosovës me Shqipërinë. Në fakt, argumentojnë ata, trojet e banuara nga shqiptarët u ndanë midis Italisë, Gjermanisë dhe Bullgarisë. Ata shprehen dakort se regjimet e reja okupuese për shqiptarët e

Kosovës ishin në fakt çlirim nga “sundimi gjenocidal serb dhe shtypja totale e të drejtave kombëtare shqiptare nga Beogradi” (Ibid., 13). Por kjo nuk do të thotë se shqiptarët ishin kolaboracionistë me fashistët dhe nazistët. Krejt e kundërta, theksojnë ata, njësitë antifashiste në Shqipëri numëronin mbi 70000 luftëtarë, ndërsa ato në Kosovë rreth 50000 luftëtarë. Për këtë arsye, akuzat se Shqipëria luftoi kundër Greqisë në vitin 1940 janë tërësisht të pabazuara. Ndaj, deportimi i Çamëve nga Greqia ishte, sipas autorëve të Platformës, një akt jolegjitim dhe shtypës. “Çështja çame vazhdon të ekzistojë dhe kërkon zgjidhje”, përfundojnë autorët (Ibid., 14-16).

Por vëmendja e autorëve të Platformës është e përqëndruar kryesisht tek Kosova. Fillimisht, ata shpjegojnë pozitën e shqiptarëve në Jugosllavinë komuniste. Sipas tyre, fundin e Luftës së Dytë Botërore e shënon një ngjarje e rëndësishme – konferenca e mbajtur në Bujan në 1 janar 1944. Përfaqësuesit shqiptarë¹⁹¹ nga e gjithë Kosova, ranë aty dakort që pas luftës popullsia e Kosovës do të ketë të drejtën të zgjedhë mbi bazën e parimit të vetëvendosjes dhe njëkohësisht shprehën vullnetin e vet për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Megjithatë, menjëherë pas mbarimit të luftës, “autoritetet e reja serbe” e hodhën poshtë rezolutën e Bujanit dhe Kosova mbeti pjesë e Serbisë. Kështu, shqiptarët në Jugosllavi nuk formuan një republikë të veçantë, megjithëse numri i tyre e tejkalonte gjashtë herë atë të malazezëve dhe dy herë atë të maqedonasve. Ata trashëguan kështu po atë pozicion inferior që kishin edhe në Jugosllavinë e paraluftës (Ibid., 17-18).

Në një parantezë të shkurtër pasuese, autorët e Platformës, riafirmojnë interpretimin zyrtar të historiografisë shqiptare përsa i përket dy pikave kryesore që lidhen ngushtë me praninë e shqiptarëve në Kosovë. Është ky një vizion historik, i cili ishte paraqitur edhe më herët në shumë publikime të tjera të AShSh. Së pari, ata hedhin poshtë hipotezën për zhvendosjen masive të shqiptarëve në Kosovë vetëm pas ngjarjeve të viteve 1689-1690. Përkundrazi, ata theksojnë autoktoninë e shqiptarëve në këtë rajon, duke u mbështetur ngushtë te vazhdimësia midis Dardanëve, fisit ilir që banonte në Kosovë dhe shqiptarëve të sotëm. Ata shtojnë se Kosova nuk mund të ketë qenë djepi i shtetit mesjetar serb, sepse ekspansioni i tij drejt jugut filloi vetëm në fund të shekullit XII. Shqiptarët kanë qenë gjithmonë të pranishëm në Kosovë, çka dëshmohet nga shumë emra familjesh nga ajo kohë, ku rrënja është shqipe, ndërsa mbarena një sufiks sllav, e siç provohet nga shumë burime, ata përbënin shumicën e popullsisë përpara “të ashtuquajturit migrimit masiv të serbëve” nga kjo zonë në vitin 1689. Prandaj “pretendimet e qeverisë serbe mbi të drejtën historike për Kosovën janë krejtësisht të pabazuara. (...) Kosova ka qenë gjithmonë dhe do të mbetet një gjymtyrë e kombit shqiptar” (Ibid., 19-21).

¹⁹¹ Konferenca zgjati nga 31 dhjetori 1943 deri në 2 janar 1944. Ky gabim në tekstin e Platformës vjen ndoshta nga fakti se në datën 1 janar u pranua dhe nënshkrua rezoluta e Bujanit, apo edhe për shkakë të tjera. Kjo gjë kuptohet, sepse kjo ngjarje historike filloi të bëhet e njohur me gjerë vetëm në vitet 90-të, ndërkohë që më herët në tekstet shkollore mungonin referencat për të. Autorët e Platformës nuk përmendin një fakt tjetër të rëndësishëm. Midis delegatëve që morën pjesë në konferencë kishte edhe delegatë serbë dhe malazezë. Kështu në komitetin e zgjedhur nga konferenca Pavlle Joviçević (Pavle Joviçević) ishte zëvendës-kryetar, ndërsa Millan Zečar (Milan Zečar) ishte anëtar.

Së dyti, ata shkruajnë më gjerë për situatën e shqiptarëve në Jugosllavinë komuniste. Ata theksojnë se territoret e banuara nga shqiptarët – pra e thënë ndryshe ish vilajeti i Kosovës – u copëtuan sërish në Jugosllavi, çka ata e quajnë “copëtimin e tretë të madh”. Pjesa jugore iu dha Republikës së Maqedonisë, luginat e Medvegjës, Bujanovcit dhe Preshevës u inkorporuan në Republikën e Serbisë, ndërsa pjesa veriore ju dha Republikës së Malit të Zi (Ibid., 23). Ata e përshkruajnë situatën e shqiptarëve në përgjithësi në Jugosllavi dhe në veçanti në Kosovë si të tmerrshme. Sipas tyre, vetëm gjatë viteve 50-të dhe 60-të të shekullit XX “si rezultat i politikës gjenocidale të policisë serbe u vranë 50000 njerëz dhe rreth 300000 të tjerë u dëbuan nga Jugosllavia” (Ibid., 24). Kushtetuta e vitit 1974 solli disa përmirësime në fushën e edukimit dhe kulturës, por njëkohësisht sanksionoi ndarjen e trojeve të banuara nga shqiptarët dhe në fakt situata e popullsisë shqiptare nuk ndryshoi edhe aq. Pikërisht kjo gjë solli tek demonstratat e vitit 1981 të cilat u shtypën me tanke. Anullimi i autonomisë së Kosovës, një akt i cili ishte në kundërshtim të plotë si me kushtetutën e provincës ashtu edhe me atë të federatës, çoi në shpërthimin e terrorit. Shqiptarët filluan të pushohen masivisht nga puna, shkollat u mbyllën dhe burgosja, migrimi dhe vrasjet u bënë realitet (Ibid., 26). Shpallja e Republikës së Kosovës më 7 shtator 1990 ishte finalizimi i aspiratave të shprehura qysh në konferencën e Bujanit e më vonë gjatë demonstratave masive në 1968 dhe 1981. Edhe pse u kufizua vetëm në Kosovë dhe “nuk përfshiu të gjitha trojet shqiptare që vuanin nën sundimin jugosllav”, ky akt, pohojnë autorët, përfaqësoi një hap përpara drejt realizimit të qëllimit kryesor të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare (Ibid., 27).

As Komisioni i Badinterit dhe as Konferenca e Paqes për Jugosllavinë nuk i njohu të drejtat e shqiptarëve për vetëvendosje, megjithëse ata përbëjnë 90% të popullsisë në Kosovë. Duke u përballur me represion, në mos me terror, shqiptarët u angazhuan në një lëvizje masive, e cila synonte t’i zgjidhte problemet e provincës vetëm me mjete paqësore. Hedhja poshtë e këtyre kërkesave nga Beogradi dhe mungesa e efikasitetit nga ana e bashkësisë ndërkombëtare ishin dy arsyt kryesore, të cilat çuan tek shpërthimi i konfliktit të armatosur dhe forcimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, theksojnë autorët. Duhet theksuar, se ata nuk i kushtojnë shumë vëmendje UÇK-së në vetvete, sepse në kohën kur u shkrua Platforma kjo organizatë ishte akoma e rrethuar nga misteri, por ata i drejtohen “Kancelerive të Mëdha” që t’i kushtojnë vëmendje faktit se kriza kosovare ka rrënjë të thella historike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Por mbi të gjitha: “është çështje e një kombi të ndarë padrejtsisht” (Ibid., 32-33).

Konteksti historik dhe politik i fundit të shekullit XX është shumë më kompleks sesa ai, në kuadër të të cilit lindi lëvizja kombëtare shqiptare, konkludojnë autorët. Asokohe, të gjitha trojet e banuara nga shqiptarët ishin pjesë e Perandorisë Osmane, sot¹⁹² ata janë të ndarë në pesë shtete. Për këtë arsye, realizimi i qëllimit të baballarëve të lëvizjes kombëtare nënkupton ndryshimin e kufijve të shteteve të njohura kombëtare në Ballkan. Autorët e Platformës e pranojnë, disi me një dozë të hidhur realizmi, se kjo gjë “për lëvizjen tonë kombëtare përbën një pengesë, e cila nuk mund të tejkalohet pa

¹⁹² Kuptohet, këtu bëhet fjalë për situatën në fund të viteve 90-të (shën i red.).

mbështetjen e faktorit ndërkombëtar” (Ibid., 34). Dukshëm nën ndikimin e ngjarjeve të atëhershme në Kosovë, ata bëjnë thirrje për ndërhyrje ushtarake me qëllim që të parandalohet katastrofa humanitare. Dhe më tej kërkojnë, që statusi i ardhshëm i provincës të zgjidhet duke u mbështetur në parimin e vetëvendosjes. Por, kjo gjë duhet të arrihet vetëm me mjete paqësore dhe demokratike, në përputhje me standardet evropiane. Për më tepër, ata theksojnë, se një zgjidhje jetëgjatë e çështjes kosovare është e lidhur ngushtë me përmirësimin e gjendjes së shqiptarëve në Maqedoni, të cilët kanë jetuar aty në vazhdimësi dhe përbëjnë “35% të të gjithë popullsisë” së vendit (Ibid., 41). Nd këtë kontekst, përfundojnë autorët, Akademia e Shkencave e Shqipërisë propozon masat e mëposhtme: “të njihet Republika e Kosovës si një pjesë përbërëse e Republikës Federale të Jugosllavisë; të trajtohen shqiptarët si qytetarë të barabartë me maqedonasit, pra t’u njihet atyre e drejta e kombit shtetformues; të ndihmohen shqiptarët në Mal të Zi për të arritur autonominë e provincës së vet’ si dhe të garantohet e drejta e shqiptarëve në Greqi për të mësuar gjuhën amtare në shkolla publike” (Ibid., 49).

Ç’histori fshihet pas historisë?

Asnjë pikëpamje e shprehur në Memorandumin e ASShA-së dhe Platformën e ASHSh-së nuk ishte e panjohur më parë. Të reja ndërkaq ishin mënyra e paraqitjes së argumenteve (programatike), institucionet e angazhuara (akademiti e shkencave) dhe ndikimi i këtyre teksteve në të ardhmen (implikimi politik). Duhet shtuar këtu edhe dy elemente të tjera shtesë: gjuha emocionale dhe urgjenca e zgjidhjeve të propozuara. Është goditës fakti se me sa lehtësi autorët e të dy dokumenteve heqin dorë nga “stili shkencor” tipik, gjuha e përmbajtur dhe përdorin fjalë, të cilat kanë një ngarkesë të theksuar semantike si psh. “gjenocid”, “sundim”, “racist”, “katastrofë” etj. Është fare e dukshme se komunikimi midis historianëve shqiptarë dhe serbë në të dy dokumentet, nëse egziston si i tillë në vetvete, i përngjan bisedës së dy shurdhëve. E vetmja nxitje për t’u angazhuar në dialog është që të hidhet poshtë arsyeja e palës tjetër.

Pa dyshim, të dy dokumentet janë shprehje të nacionalizmit shqiptar dhe serb, në kuptimin që i jep këtij nocioni Izaja Berlin (Isaiah Berlin) në esenë e tij të shkëlqyer mbi këtë fenomen, pra në kontekstin e vënies në plan të parë të interesave kombëtare, çka implikon urgjencën për eliminimin e të gjitha pengesave në rrugën e realizimit të këtyre interesave (Berlin, 2002, 472). Të dy kombet, shqiptari dhe serbi, shfaqen në këto dokumente si entitete substanciale, të dhëna një herë e përgjithmonë, homogjene, të cilat përballen me rreziqe katastrofike për vetë ekzistencën e tyre. Por njëkohësisht janë të rëndësishme edhe motivet që shtojnë autorët e këtyre dy dokumenteve. Ata i veçojnë ato shprehimisht: shqetësimi për fatin e kombit dhe ndjenja e detyrës (Mihailović, Krestić, 1995, 9; Platform 1998, 4). Por ata shkojnë edhe më tej, duke e paraqitur veten si burim autoritativ të dijes, prandaj i vihet theksi autorësisë institucionale, grupit dhe jo individit. Natyrshëm, autoriteti i të dy Akademive jo vetëm që legjitimonte versionet historike të paraqitura në të dyja dokumentet, por i jepte kredibilitet politik edhe zgjidhjeve të propozuara prej autorëve të tyre. Në një mënyrë të qartë dhe të përmbledhur, ata ofronin

një diagnozë racionale të situatës së tanishme, identifikonin burimet e problemeve në të kaluarën dhe jepnin zgjidhje për të ardhmen. Nga kjo pikëpamje autorët e paraqisnin vetveten si avangarda e kombit, një pozicion i cili i përshtatet plotësisht vizionit romantik të intelektualëve si zgjuer të vetëdijes kombëtare dhe funksionit të tyre shoqëror si ruajtës të dijes. Vetëm një hap e ndan këtë pikë nga angazhimi politik dhe duket se autorët e të dy dokumenteve atë hap e hodhën, sepse nuk gjeneruan vetëm ide, por propozuan edhe strategji dhe mjete në funksion të materializimit praktik të tyre.

Sot dimë shumë më tepër rreth procesit të përgatitjes së të dy dokumenteve. Gjatë një mbledhjeje të Asamblesë së ASShA në maj të vitit 1985 u mor vendimi për të paraqitur pikëpamjet e Akademisë mbi problemet shoqërore të atëhershme. Në qershor u formua një komitet me në krye zëvendës-presidentin e ASShA, shkrimtarin Antonije Isaković (Isaković) dhe me anëtarë, ndër të tjerë, historianët Rade Samarxhiq (Samardžić) dhe Vasilije Krestiq (Krestić), filozofin Mihajlo Marković (Mihailo Marković) dhe ekonomistin Kosta Mihajloviq (Mihailović). U krijuan dy grupe pune, të cilat merreshin respektivisht me krizën jugosllave dhe gjendjen e problemeve kombëtare serbe (Mihailović, Krestić, 1995, 13). Kur akoma po punohej për versionin përfundimtar, dokumenti doli në dritë (Mihajloviq dhe Krestiqi theksojnë se ai u vodh) dhe u botua nga e përditëshmjja *Večernje Novosti* në 24 shtator 1986. Shpërtheu skandali, të cilit i pasoi një presion i fortë si nga autoritetet republikane ashtu edhe ato federative që Akademia ta rishikonte edhe një herë pozicionin e saj. Madje, ndërhyri edhe Ivan Stamboliq (Stambolić), asokohe kryetari i presidencës së Republikës së Serbisë. Në këtë atmosferë skandali, akuzash dhe kritikash nga gjithë Jugosllavia, Asambleja e ASShA-së vendosi më 5 tetor të ndalojë punën e mëtejshme mbi tekstin e Memorandumit. Megjithatë, në takimin e saj pasardhës më 18 dhjetor shumica dërrmuese e anëtarëve të Akademisë nuk pranoi të hiqte dorë nga Memorandumi dhe i dha votëbesimit udhëheqjes së atëhershme të këtij institucioni (Ibid., 19).¹⁹³ Prapëseprapë, siç e theksojnë disa herë Mihajloviq dhe Krestiqi në analizën e vet të shkruar gati pas një dekade, Memorandumi nuk e mori kurrë statusin e një dokumenti të pranuar dhe të botuar zyrtarisht nga ASShA-ja.

Platforma e AShSh-së u shkrua në rrethana të tjera, por gjithashtu si rezultat i nismës dhe përpjekjeve të intelektualëve dhe shkencëtarëve. Sigurisht, përgatitja e dokumentit erdhi si reagim ndaj asaj, çka po ndodhte në Kosovë. Megjithatë, siç sugjerohet në një raport të Grupit Ndërkombëtar të Krizave, mund të ketë qenë edhe një ndërmarrje e vetëdijshme për të rivendosur prestigjin e AShSh-së, i cili u ul shumë pas rënies së regjimit komunist në Shqipëri (ICG, 2004, 11). Ky interpretim duket i kënaqshëm, kur merret parasysh se qeveria e re demokratike nuk tregoi gadishmëri të financonte AShSh-në, sepse e trajtonte atë si një institucion mbështetës të regjimit të kaluar. Por në vitin 1998 situata ndryshoi pas ardhjes në pushtet të Partisë Socialiste dhe pas emërimit prej qeverisë të organeve të reja drejtuese të Akademisë. Në një intervistë për

¹⁹³ Vetëm dy akademikë kërkuar hapur rishikimin e tekstit të Memorandumit, Pavle Saviq (Pavle Savić) dhe Vaso Čubriloviq (Čubrilović). Reagimi i këtij të fundit ëdhtë për t'u vënë në pah, sepse në dy dokumente të shkruara respektivisht në vitet 1937 dhe 1945 ai kishte kërkuar hapur dëbimin e shqiptarëve nga Kosova. Për këtë arsye Čubriloviq shihet nga shkenca shqiptare si simbol i shovinizmit dhe hegjemonizmit serb (Elsie, 2002, 97-130; 149-170).

të përjavshmen *Klan*, presidenti i atëhershëm i ASHSh-së, Ylli Popa¹⁹⁴ dha sqarime mbi procesin e përgatitjes së Platformës. Versioni i saj i parë u shkrua, diskutua dhe pranua nga Asambleja e ASHSh-së dhe më pas iu dërgua për shqyrtim dhe sugjerime figurave të shquara intelektuale në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Pasi u mblodhën të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet, u përgatit versioni final, i cili u publikua në shqip, anglisht dhe frëngjisht. Është për t'u shënuar ky theksim prej Popës i faktit, që teksti i Platformës iu nënshtrua paraprakisht një diskutimi intelektual mbarë-shqiptar, çka vërtetonte edhe një herë ambiciet e autorëve për të folur nga pozita e zërit të kombit.

Por të dy dokumentet reflektonin ide, të cilat prej kohësh ishin të pranishme në veprat e shkencëtarëve serbë e shqiptarë dhe funksiononin në diskursin publik. Memorandumi i ASShA shpesh trajtohet si njëri prej dokumenteve, apeleve, teksteve dhe librave të përgatitura në atë periudhë, ku shprehej shqetësimi i intelektualëve mbi situatën e serbëve në Kosovë dhe në Jugosllavi në përgjithësi (shih më gjerë Dragović-Soso, 2002, 127-139). Pa dyshim, ky dokument është më i rëndësishmi në serinë e shprehjeve të ndryshme që simbolizojnë ngritjen e nacionalizmit serb në gjysmën e dytë të viteve 80-të. Dhe sigurisht, duket qartë ndikimi i Memorandumit në ndryshimet politike të ndërmarra nga Sllobodan Millosheviqi pas ardhjes së tij në pushtet, sidomos përsa i përket statusit të Kosovës dhe të Vojvodinës. Nga ana tjetër, siç theksonte Ylli Popa në intervistën e vet, në Platformë u propozuan zgjidhje politike, të cilat më vonë u implementuan në Marrëveshjen e Ohrit. Por madje edhe vetë teksti përfundimtar i Platformës u quajt nga rrethe nacionaliste shqiptare si minimalist, sepse në të nuk u shpreh haptas se e vetmja zgjidhje e çështjes shqiptare do të ishte bashkimi i të gjitha trojeve të banuara nga shqiptarët në Ballkan. Popa i hodhi poshtë këto akuza, duke ritheksuar se Platforma nuk kërkoi ndryshimin me dhunë të kufijve në Ballkan, por doli në mbrojtje të të drejtave të shqiptarëve.

Është shumë e rëndësishme të shihet, se vazhdimësia e ideve është më e dukshme, kur bëhet fjalë për çështje historike. Të dy dokumentet rikapitulojnë dhe riafirmojnë elementet dominuese respektivisht në historiografitë serbe dhe shqiptare, sidomos kur fjala është për Kosovën. Mjafton të nxirren në pah dy fakte. Vetëm disa muaj pas shpërthimit të skandalit rreth Memorandumit, ASShA botoi opus magnum të njërit prej anëtarëve të saj, historianit Dimitrije Bogdanoviq (Bogdanović), të titulluar *Libri për Kosovën (Knjiga o Kosovu)*. Nëse marrim në konsideratë, se ky libër u pranua për publikim në vitin 1984 dhe se redaktori kryesor i tij ishte Antonije Isakoviq, i cili u zgjodh në krye të komitetit përgjegjës për përgatitjen e Memorandumit, atëherë lidhja bëhet shumë e qartë. Por edhe sikur të mos ekzistojë lidhja personale, pa asnjë dyshim libri i Bogdanoviqit dhe Memorandumi kanë ngjashmëri tejet të dallueshme. Duke shkruar më tej, tezat kryesore të paraqitura në Platformë mund të gjenden shumë lehtë në një publikim tjetër, më të gjerë, të ASHSh-së, të titulluar *E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, i cili u pa dritën e botimit në 1990. Mund të gjendet aty po i njëjti theksim i etnogjenezës iliro-shqiptare, i masivitetit të pranisë shqiptare në Kosovë gjatë mesjetës, si dhe i viktimizimit të shqiptarëve në Jugosllavi (të) në shekullin XX. E parë nga ky këndvështrim, Platforma është vetëm një version i kondensuar i ideve, që gjenden në thelb të historiografisë moderne shqiptare.

¹⁹⁴ Profesor i shkencave mjekësore dhe një nga ish mjekët e Enver Hoxhës.

Konkluzione

Një arkeologji e mirëfilltë dhe e detajuar e kësaj vazhdimësie të ideve në kuptimin që i jep këtij koncepti Mishel Fuko (Michel Foucault) do të kërkonte një studim më të gjerë, kështu që po mjaftohem këtu me vënien në pah të disa cilësive të përbashkëta të Memorandumit dhe Platformës. Të dy dokumentet dhe vargu i ideve, që ato përmbledhin, tregojnë një ngjashmëri tejet të dukshme strukturore, e cila konsiston në: a) demonizimin e *tjetrit*; b) viktimizimin e *neve*; dhe c) paraqitjen e pikëpamjeve *tona* si të natyrshme, normale, e prej këtej si normative, ndërkohë që pikëpamjet e *tyre* trajtohen si të rreme dhe të gabuara. Nëse do ta kufizonim spektrin e analizës vetëm tek Kosova, atëherë duket qartë se të dy dokumentet paraqesin një vizion të njëanshëm, i cili i jep përparësi vetëm njërës palë, duke e përjashtuar palën tjetër. Kjo përzgjedhje ka pasoja të qarta politike, sepse kërkon të legjitimojë dhe/apo justifikojë aksione politike të kryera në të kaluarën, apo të perceptuara si të nevojshme në të ardhmen. Për më tepër, ky është një vizion historik i cili synon të jetë hegjemonial si në kohë ashtu edhe në hapësirë, duke mos i marrë parasysh larminë e kënvështrimeve dhe amplitudat e procesit historik. Për këtë arsye autorët e të dy dokumenteve bëjnë të njëjtin gabim metodologjik të anakronizmit, sepse përdorin kategorinë e kombit për të shpjeguar ngjarje historike jashtë kontekstit bashkëkohor. Së fundi, të dy dokumentet tregojnë një indiferencë të dallueshme dhe mungesë të thellë të njohjes së palës tjetër, apo e thënë më mirë, ato mbështeten mbi besimin se e gjithë dija e nevojshme tashmë është arritur dhe se nuk ka nevojë për dialog të mëtejshëm. Për fat të keq, me disa përjashtime të vogla, kjo është një tendencë, e cila vazhdon të jetë e pranishme në marrëdhëniet shqiptaro-serbe.

Ndërkohë që Platforma mbetet akoma e panjohur për shkencëtarët serbë, Memorandumi u bë objekt i analizës së intelektualëve shqiptarë, fillimisht në Kosovë, e pastaj edhe në Shqipëri. Ndoshta, tonin diskutimit ja dha Fehmi Agani, një nga sociologët më në zë kosovarë, i edukuar në Beograd dhe një nga figurat kryesore politike që ideuan dhe drejtuan lëvizjen paqësore të shqiptarëve në vitet 90-të. Për Aganin “metoda e Memorandumit është metoda tinzare e lamentit për fatin tragjik të popullit serb, duke fjetur arsyen dhe mobilizuar emocionet në drejtim të qëllimit të synuar” (Agani, 1994, 141). Viktimizimi i kombit serb dhe akuzat se shqiptarët po bëjnë luftë kundër serbëve, për mendimin e Aganit, ishin në fakt një deklaratë lufte. Ai e përfundon kritikën e vet duke shprehur mendimin se vetëm urtia dhe vetëpërmbajtja e shqiptarëve në Kosovë bënë që të evitohej lufta me përmasa tragjike (Ibid., 150). Por më në fund tragjedia ndodhi dhe Agani u bë një nga viktimat e saj.¹⁹⁵ Më mbetet

¹⁹⁵ Fehmi Agani shijei si një nga strategët kryesorë të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe një nga figurat kryesore në skenën politike kosovare. Më 6 maj 1999 Agani bashkë me familjen e vet gjendej midis shqiptarëve të dëbuar nga forcat policore serbe në një tren për në Maqedoni. Treni u kthye në kufi dhe pranë Fushë Kosovës Agani u morr nga një njësi e policisë serbe, ndërsa e shoqja dhe i biri i tij u kthyen në Prishtinë. Trupi i pajetë i profesor Aganit u gjend të nesërmen buzë rrugës pranë Lipjanit. Policia serbe bëri publike një deklaratë, në të cilën akuzoi UÇK-në për rrëmbimin dhe vrasjen e Aganit. Por në vitin 2002, Fondi për të Drejtat Njerëzore në Beograd botoi një artikull, ku jepën shumë detaje rreth vrasjes së Aganit si dhe emrat e dy policëve, të cilët sipas të gjitha gjasave kryen vrasjen.


vetëm të hamendësoj, nëse do ta kishte vënë re, se megjithë ndryshimet në ton fjalët e tij mund të aplikohen edhe për të cilësuar Platformën. Por mund të imagjinoj se se ai do të binte dakort me Nebojsa Popovin (Nebojša Popov) se “në vend të shikimit të nacionalizmit në një mënyrë të përgjithësuar, si një prodhim të fatit apo të natyrës, i cili mund të konsiderohet i mirë apo i keq, ne duhet të synojmë të hetojmë fillimet e vërteta të tij dhe mënyrën se si kthehet në ideologji konflikti” (Popov, 2000, 1). Pikërisht këtij lloji kuptimi synon t’i kontribuojë ky artikull.

Literatura:

- AGANI, F. (1994) *Demokracia, kombi, vetvendosja*. Pejë: Dukagjini.
- BAHTIN, M. (1982) *Problemy literatury i estetyki*. Warszawa: Czytelnik.
- BERLIN, I. (2002) *Pod prąd. Eseje z historii idei*. Poznan: Zysk i S-ka.
- DRAGOVIĆ-SOSO, J. (2002) *Saviours of the Nation? Serbia's Intellectual Opposition and the Revival of Nationalism*. London: Hurst.
- ELSIE, R. (2002) *Gathering Clouds. The Roots of Ethnic Cleansing in Kosovo and Macedonia. Early Twentieth-century Documents*. Pejë: Dukagjini.
- GELLNER, E. (1991) *Nations and Nationalism*. Bot. II. Ithaca: Cornell University Press.
- HROCH, M. (1985) *Social Preconditions of National Revival in Europe. A Comparative Analysis of the Social Composition of Patriotic Groups among the Smaller European Nations*. Cambridge, London, New York: Cambridge University Press.
- MALIQI, Sh. (1993) *Shqiptarët dhe Evropa*. Pejë: Dukagjini.
- MIHAILOVIĆ, K., KRESTIĆ, V. (1995) *Memorandum of the Serbian Academy of Sciences and Arts. Answers to Criticism*. Belgrade: Serbian Academy of Sciences and Arts.
- ICG. (2004) *Pan-Albanianism: How Big a Threat to Balkan Stability?* Europe Report N°153.
- POLLO, S., BUDA, A. (1965) *Historia e Shqipërisë*, Vol. II. Tiranë: Universiteti Shtetëror I Tiranës.
- POPOV, N. (red.) (2000) *The Road to War in Serbia. Trauma and Catharsis*, Budapest: CEU Press.
- PLATFORM FOR THE SOLUTION OF THE NATIONAL ALBANIAN QUESTION (1998). Tirana: Akademia e Shkencave e RSH.
- SKENDI, S. (1980) *Balkan Cultural Studies*. New York: Columbia University Press.

Burime internet:

Intervistë me prof. Ylli Popën. Gjetet në www.revistaklan.com/arshiv2/216/popa.asp [e parë më 20.04.2015].



Rigels Halili

Centre for East European Studies
University of Warsaw

“*We, the Sons of the Nation*” – Intellectuals as Generators of Albanian and Serbian National Ideas and Programs

Abstract:

The paper offers a historical and textual comparative analysis of two very important documents: the Memorandum of the Serbian Academy of Sciences and Arts written in 1986, and the Platform for the Solution of the National Albanian Question presented by the Albanian Academy of Sciences in 1998. On this basis, the paper inquires on the role of intellectuals as generators of national ideas, ideologies and programs. The article provides a detailed analysis of both documents and thereafter offers an analysis of the socio-political contexts, in which both texts were produced. Simultaneously, the article tried to contextualise both these documents in the Serbian and Albanian nationalist discourses respectively.

Key words:

intellectuals, nationalism, political ideas, political programmes

